



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:240529

Datë: 14.10.2021

Numri i dokumentit: 02287213

EK.nr.100/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Adnan Konushevci, duke vendosur në çështjen juridike sipas padisë së paditëses P.C. Sh.p.k., me numër të biznesit Nr., me adresë në M. P. – F. K., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit firma e avokatisë V. & L., me avokatet A. V., F. L., U. V. dhe S. E., me seli në P., Rruga “B.”, H. CNr./Nr., Nr., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.”, me numër të biznesit Nr..., me seli në P., Rruga “Nr. K.”, Nr., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit A. K., jurist i diplomuar, me objekt kontesti pagesa e garancionit, vlera e kontestit 20,349.06 euro, në seancën e shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 04.10.2021, në praninë e përfaqësuesve të ndërgjyqësve, ndërsa datë 14.10.2021, jep këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditëses P. C. Sh.p.k., me numër të biznesit Nr...., me adresë në M. P. – F. K., **Detyrohet** e paditura Kompania e Sigurimeve “E.”, me numër të biznesit Nr...., me seli në P., Rruga “Nr. K.”, Nr., që paditëses t’ia paguajë, shumën prej 20,349.06 euro (njëzetmijë e treqind e dyzetënëntë euro e gjashtë cent), në emër të ekzekutimit të sigurisë së garancionit, me kamatë ligjore në lartësi prej 8 % në vit, duke filluar llogaritja e kamatës nga data 21.02.2019, dita e paraqitjes së padisë dhe kërkesëpadi në këtë gjykatë, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e kësaj procedure, në shumën prej 2,198.00 euro (dymijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m i

Paditësja, në këtë gjykatë, me datën 21.02.2019, ka paraqitur padi dhe kërkesëpadi, kundër të paditurës, me objekt kontesti, pagesa e garancionit. Me të cilën kërkon që të detyrohet e paditura që paditëses t’ia paguajë, shumën prej 20,349.06 euro (njëzetmijë e treqind e dyzetënëntë euro e gjashtë cent), në emër të ekzekutimit të sigurisë së garancionit, me kamatë ligjore në lartësi prej 8 % në vit, duke filluar llogaritja e kamatës nga data 21.02.2019, dita e paraqitjes së padisë dhe

kërkesëpadi në këtë gjykatë. Sepse nga garancioni me numër serik të policës 09/18 të datës 23.05.2019, vërtetohet se e paditura e ka garantuar paditësin se do t'ia paguajë paditësit deri në 50,000.00 në rast se kompania H.S.A C. nuk e paguan borxhin. Sipas paditëses, me këtë garancion e paditura e ka garantuar paditësin se pagesa e shumës së limituar deri në 50,000.00 euro do, të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, me kërkesën e parë, sipas Garancionit Nr. 90/18 të datës 23.05.2018. Në rastin konkret, sipas paditëses nuk është kontestuese që urdhërdhënësi H.S.A C., pas nënshkrimit të kontratës për shitblerjen e derivateve (e cila kontratë është siguruar me sigurinë e ekzekutimi) është furnizuar me derivate tek paditësi dhe nuk ka pasur vërejtje lidhur me sasinë, cilësinë e derivate apo faturimin. Faturat i ka pranuar dhe i ka nënshkruar pa vërejtje, mirëpo urdhërdhënësi H.S.A C. ka dështuar që të përmbush, obligimin e tij ndaj shfrytëzuesit të garanacionit në këtë rast paditsi, në shumë 20,349,06 euro. Pasi që urdhërdhënësi H.S.A C., ka dështuar që ta përmbush obligimin ndaj shfrytëzuesit të garanacionit - paditëses, atëherë shumë prej 20,349,06 euro, e paditura duhet t'ia paguaj menjëherë paditësit pa asnjë kundërshtim as ankesë, dhe pastaj e paditura këtë shumë të paguar, në bazë të nenit 1087 para. 2 të LMD-së së vitit 1978 mund ta rimbursoj nga urdhërdhënësi H.S.A C. Nga faturat e blerjes me Nr. 1769/18 e datës 31.05.2018 dhe fatura Nr. 2015/18 e datës 30.06.2018, vërtetohet se kompania "H.S.A C." është furnizuar me derivate tek paditësi, në shumë 20,349.06 euro. Kjo shumë vërtetohet e nga "Voucherët/fletëpranimi i mallit". Me propozim për gjykatën që kërkesëpadi e paditëses të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, me përgjigjen në padi dhe gjatë seancave të mbajtura në këtë rast e ka kontestuar pjesërisht kërkesëpadinë si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia. Pasi që e e paditura konsideron se sasia e derivateve të furnizuar nga ana e paditëses të cilat ju kanë dhënë palëve të treta nuk janë obligim i të paditurës që ti kompensojë pasi që të njëjtat sasi i janë furnizuar jashtë kontratës e cila është siguruar nga ana e tani të paditurës. E paditura ka siguruar një kontratë për shitblerjen e derivateve, e cila në Nenin 4.1 të saj parasheh specifikisht furnizimin e veturave dhe mjeteve tjera motorike të blerësit. Sipas të paditurës Garancioni - Siguria e ekzekutimit Nr. 03421, specifikisht parasheh dy rastet kur mund të kërkohet ekzekutimi i garancionit, për çka e paditura konsideron se kërkesa e paditëses për ekzekutim të garancisë perfshinë vetëm sasinë prej 8.877.36 litra, për çka e ka pranuar tani e paditura në vazhdimësi të paguajë. Përderisa pjesa tjetër e paditura pretendon se është jashtë Garancionit - Siguria e ekzekutimit Nr. 03421, për faktin se kontrata ka qenë decidive se kush mund të furnizohet dhe ka qenë obligim i palëve të

rregullojnë një relacion te tillë përkatësisht te parashohin një gjë te tillë. Përderisa pretendimi i paditëses se nuk duhet analizuar kushtet e garancionit pasi qe garancioni përmban klauzolën me thirrjen e parë dhe pa kundërshtim, ne bazë te nenit 1087 te LMD-se, së vjetër nuk është i elaboruar drejtë pasi qe kemi te bëjmë me nene te cilat plotësojnë njëra tjetrën. Pra, nuk mund te zbatohet vetëm neni 1087, pa u referuar ne Nenin 1083 te LMD-së së vjetër, te cilat e plotësojnë njëra tjetrën. Mëtej e paditura thekson se garancioni lëshohet nën kushte te caktuara te cilat ne rast se plotësohen garancion dhënësi pa kundërshtim do ta zbatojë përkatësisht paguaj obligimin ne emër te palës se tretë. Prandaj ne këtë drejtim e paditura ne vazhdimësi ka theksuar se nuk e kundërshton pagesën e çmimit prej 8.877.36 litra, por asesi ne tërësi te paguaj shumen pasi qe nuk janë plotësuar kushtet e garancionit, per çka është konstatuar edhe me ekspertizën e grupit te eksperteve. Me propozim për gjykatën që të aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e paditësit, vetëm për furnizimet që janë të furnizuar mjetet motorike të H.S.A C., por e jo edhe furnizimet nga palët e treta.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata, për të vërtetuar gjendjen faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor administroi provat si në vijim: Kontratën për Shitblerjen e Derivateve e datës 31.05.2018, Sigurinë e ekzekutimit me nr. Serik të policës: 90/18 i datës 23.05.2018, Faturën me nr.1769/18 e datës 31.05.2018 dhe fatura me nr.2015/18 1100 e datës 30.06.2018, Të gjithë vaucherët, në shkresat e lëndës, Komunikimet elektronike nëpërmes email-ve të datave 10.12.2018, 28.12.2018, 25.09.2018, 31.07.2018, 02.08.2018, 02.08.2018, 03.08.2018, 03.08.2018, 10.08.2018, 28.08.2018 dhe email-i i datës 29.08.2018, Ekspertizën financiare te ekspertit F. K., e datës 29.01.2021, sqarimet plotësues të dhëna nga i njëjti ekspert, në seancën e datës 24.05.2021, plotësimi me shkrim i datës 26.05.2021, nga i njëjti eksperti, dhe po ashtu sqarimet e dhëna nga i njëjti ekspert në seancën e datës 13.07.2021, Ekspertiza e punuar nga grupi i ekspertëve Sh. B., R.I. dhe E. P. e datës 16.08.2021, dhe sqarimet plotësuese të dhëna nga ekspertët e njëjtë, në seancën e datës 04.10.2021.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat ligjore të neneve 7 dhe 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për arsyet ne vijim:

Në këtë rast nuk është kontestuese në mes të paditëses dhe H.S.A C., është lidhur Kontrata për Shitblerjen e Derivateve e datës 31.05.2018, dhe nuk është kontestuese se sigurimin e ekzekutimit-garantimin të kontratës së lartcekur e ka bërë e paditura sipas Policës së sigurimit: 90/18 i datës 23.05.2018, me deklaratën e garantuesit ka marrë detyrimin e shfrytëzuesit të sigurimit, përkatësisht paditëses t'ia bëjë pagesën, me kërkesën e parë, pasi që nuk është kontestuese se H.S.A C. ka dështuar që ti përmbushë detyrimet që kanë rezultuar nga kontrata e lartcekur.

Kontestuese në këtë rast mes ndërgjyqësve është çështje e furnizimit me derivate e palëve të treta, respektivisht automjetet që janë furnizuar me derivate nga paditësja, e që nuk ishin sipas të paditurës në kohën e furnizimit në pronësi të H.S.A C., për të cilën kompani e paditura ishte garantuese.

Për gjykatën dhe ndërgjyqësit edhe pse Kontrata për Shitblerjen e Derivateve e datës 31.05.2018, që ishte e lidhur në mes të paditëses dhe H.S.A C., nuk ishte kontestuese, se si kanë kontraktuar ato mes tyre, për ofrimin e shërbimeve sa i përket furnizimit me derivate, të përcaktuara më specifikisht në kontratën e lartcekur. Megjithatë gjykata gjeti arsye të vlerësoi të njëjtën, pasi që e paditura me anë të përgjigjes në padi dhe gjatë gjithë kësaj procedure, e ka kontestuar se paditësja ka qenë e obliguar që ti furnizojë me derivate mjetet motorike vetëm të blerësit, në kuptim të nenit 4 pikat 1 dhe 3, të kontratës së lartcekur. Gjykata këtë pretendim të paditurës e vlerëson në tërësi si të pa qëndrueshëm ngase në nenin 4 pikat 1 dhe 3 të kontratës së lartcekur, e as me ndonjë nen tjetër i kësaj kontrate, nuk e përcakton se mjetet motorike që do të furnizohen me derivate nga paditësja të jenë në pronësi të H.S.A C., me rastin e furnizimi as që ka qenë e obliguar paditësja që ta bënë këtë verifikim.

Gjykata, vlerëson se paditësja në këtë rast ka vepruar konform kontratës së lartcekur, duke e furnizuar H.S.A C., sipas kërkesave të saj, ku edhe për çdo furnizim të ofruar siç është përcaktuar me kontratë është plotësuar v., të cilët janë plotësuar në tri kopje, një kopje është marrë nga drejtuesi i mjetit motorik që është furnizuar me derivate tek paditësja, dhe dy kopje kanë mbetur tek paditësja, nga të cilët v. në mënyrë të padyshimtë është konstatuar se cili person është furnizuar me derivate me mjetin e tij tek paditësja, duke e përfshirë tabelat e regjistrimit të mjetit që është furnizuar me derivate, sasinë e derivateve të furnizuar, datën dhe orën e furnizimit dhe në fund të muajt paditësja i'ka përpiluar faturat me nr.1769/18 e datës 31.05.2018 dhe fatura me nr.2015/18 1100, e datës 30.06.2018, për të gjitha këto rezulton se H.S.A C., ka qenë në

vazhdimësi në dijeni se kush dhe si është duke u furnizuar tek paditësja, prandaj pretendimet e paditurës lidhur me kontestimin e nenit 4 pikat 1 dhe 3 janë tërësisht të paqëndrueshme.

Për më tepër gjykata vlerëson se pretendimet lartcekura të paditurës, as që janë në legjitimitetin e saj që ti potenconte se kush është furnizuar tek paditësja, ngase e paditura nuk ishte pjesë e kontratës së lidhur në mes të paditëses dhe H.S.A C., por e paditura është vetëm garantuese e ekzekutimit të sigurimit të kësaj kontrate, po që se dështon që ti përmbush detyrimin që rezultojnë nga kontrata e lartcekur H.S.A C., siç edhe ka dështuar në këtë rast. Prandaj pretendimet se kush është furnizuar apo kush ka pas të drejtën që të furnizohet me derivate, është të kontestohen nga H.S.A C., po në asnjë rast nga e paditura si garantues e sigurimit.

Gjykata, nga konstatimet e lartcekura, vjen në përfundim, lidhur me pretendimet e të paditurës sa i për këtë furnizimit të mjeteve motorike që nuk janë në pronësi të H.S.A C., të cilat pretendime, janë në tërësi të paqëndrueshme që të ngritën nga e paditura si ofrues i garancionit në thirrje të parë, për faktin se lloji i garancionit i ofrua nga e paditura, është garancion pa kundërshtim – në thirrje të parë, në kuptim të nenit 1087 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD i vitit 1978), i cili përcakton se: *“Në qoftë se garancia bankare përmban klauzolën pa kundërshtim, me thirrjen e parë, ose përmban fjalë që kanë domethënie të njëjtë, banka nuk mund të theksojë ndaj shfrytëzuesit kundërshtime që urdhërdhënësi, si debitor mund t'i theksojë ndaj shfrytëzuesit sipas detyrimit të siguruar”*.

Gjykata, për të vlerësuar lartësinë e kërkesëpadisë, ka caktuar nxjerrjen e provës me Ekspertizën financiare të ekspertit F. K., e datës 29.01.2021, dhe pasi që e paditura nuk ishte pajtuar me konstatimet e këtij eksperti, me propozim e saj gjykata ka nxjerr provën me Ekspertizë të punuar nga grupi i ekspertëve Sh. B., R. I. dhe E. P. e datës 16.08.2021. Këto dy prova të lartcekura janë tërësi më harmoni njëra me tjetrën sa i për këtë lartësisë së kërkesë së paditëses dhe shkresave tjera të lëndës, dhe nuk ka ndryshime në lartësinë e konstatimeve nëmes të ekspertizave të datave të lartcekura, dhe në të dy ekspertizat janë dhënë sqarimet e nevojshme, prandaj gjykata ka ardh në mënyrë të pa dyshimtë, që këtyre ekspertizave t’iu falë besimin lidhur me lartësinë e kërkesës së paditëses, të gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pas që ekspertizat në fjalë janë profesionale dhe me arsye të mjaftueshme për vendosur lidhur me lartësinë e kërkesës.

Pas vlerësimeve dhe konstatimeve si më lart gjykata vjen në përfundim, bazueshmëria r kërkesës është e bazuar ndërsa kontrata e garancionit bankar është e rregulluar në dispozitat e nenit 1083, 1084, 1085, 1086 dhe 1087 i LMD-së (i viti 1978), pasi që me LMD-në (të vitit 2012), nuk është

rregulluar posaçërisht kjo kontratë, por LMD (i vitit 2012), me nenin 1058 paragrafi 3, i'ka lënë në fuqi nenet 1083 deri 1087 të LMD-së (të viti 1978). Prandaj, gjykata në vlerësimin ligjor të kërkesëpadi së, ka zbatuar dispozitat e lartpërmendura ligjore, si dispozita të aplikueshme për rastin lëndor.

Gjykata, me rastin e vendosjes mori parasysh edhe pretendimet e të paditurës siç janë dhënë vlerësimet e lartcekura por kontestimet në këtë procedurë të paditurës si për nga bazueshmëria e kërkesës së paditëses ashtu edhe për nga lartësia e saj, kanë qenë pa ndikim për të vendosur ndryshe në këtë rast.

Prandaj pasi që e paditura është hy ne detyrime si garantues i H.S.A C., bazuar në Sigurinë e ekzekutimit me nr. Serik të policës: 90/18 i datës 23.05.2018, konform nenit 8 paragrafi 1 të LMD-së, (i vitit 2012), është përcaktues se: *“ Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”*. Ndërsa me nenin 245 i LMD-së, (të vitit 2012), përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënie detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit, si dhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për shkak të mos përmbushjes së detyrimit apo vonesës në përmbushje, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi”*. Prandaj, gjykata ka ardhur në përfundimin se e paditura ka për obligim që të zbaton detyrimet e marra përmes kontratës së garancionit, të lartcekur.

Gjykata përveç çështjes kryesore në këtë rast aprovojë edhe kërkesën e paditëses lidhur me kamatëvonesën ashtu që e paditura obligohet që lartësinë e kamatës prej 8% në vit, duke u bazuar në nenin 382 paragrafët 1 dhe 2 të LMD-së (të vitit 2012) dhe Mendimin Juridik për Kamatën me nr. 265/2020 i datës 02.12.2020, i dhënë nga Gjykata Supreme e Kosovës, duke filluar përllogaritja e kamatës nga data 21.02.2019, dita e paraqitjes së padisë dhe kërkesëpadi në këtë gjykatë, e deri në pagesën definitive.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 452 paragrafi 1 i LPK-së, sipas së cilës paditëses i pranohen shpenzimet në emër të: përpilimit të padisë dhe kërkesëpadi së në shumën prej 208.00 euro, në emër të përfaqësimit për 7 seanca shumën prej 1,890.00 euro (për secilën seancë nga 270.00 euro), dhe në emër të taksës gjyqësore, shumën prej 100.00 euro, apo shumën e përgjithshme të shpenzimeve për këtë procedurë, në lartësi prej 2,198.00 euro.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Ekonomike
EK.nr. 100/19 të datë 14.10.2021**

Gjyqtari,
Adnan Konushevci

***KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.*